




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____ 2018

Lënda: Amendament për projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Drejtuar: z. Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

*15.10.2018. Tel. për z. Gramoz Ruçi
10.10.2018. 10 orë
10.10.2018. 10 orë*

I nderuar z. Kryetar,

Mbështetur në nenin 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, propozoj që në projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhet shtesa e mëposhtme:

Pas nenit 4, të variantit integral të propozuar nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat shtohet neni 4/1 më këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Në nenin 52, pika 2, riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Të ardhurat bruto nga loja, përveç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj të veçantë, për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit taten në masën 15 për qind, me përjashtim të kategorive “Kazino”/ “Kazino në hotele me 5 yje” dhe “Resort kazino” të cilët taten në masën 30%.


DEPUTETI

Erjon BRACE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI



Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/2018

Lënda: Amendament për projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Drejtuar: z. Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

*Të ftoj të
më bashkëpunojnë
dhe të mirëpresin
24.10.18*

I nderuar z.Kryetar,

Mbështetur në nenin 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, propozoj që në projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhet shtesa e mëposhtme:

Pas nenit 3, të variantit integral të propozuar nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, shtohet neni 3/1 më këtë përmbajtje:

Neni 3/1

Në nenin 4, pika 13, riformulohet sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“13.“Hotele me 5 yje” janë hotelet, të cilat kanë marrë certifikatën e akreditimit për këtë klasifikim nga institucionet ndërkombëtare akredituese dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar, të certifikuar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.”

DEPUTETI

Ervin BUSHATI